



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 1.10.2021

Lënda: Mendim i Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 1.10.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbi caktimin e çështjeve për kryerjen e aktit të ekspertimit në çështjen ankim kundër vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Sokol Ngresi

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 227 i KPRC-së

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të dispozitës së nenit 227 të KPRC-së, në kushtet kur trupi gjykues ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit në lidhje me aktet origjinale të administruara gjatë seancës së kaluar gjyqësore, Komisioneri Publik është i mendimit që duhet të shtrohet për trajtim çështja:

- Nëse në aktet origjinale të administruara nga trupi gjykues, në seancën e datës 9.9.2021, përkatësisht:

1. Kontratë paraprake për shitje pasurie të paluajtshme nr.*** rep., datë **.2.2014, akt i Shoqërisë “**** ****” sh.p.k.;
2. Mandat arkëtimi nr. ***, datë **.2.2014, i Shoqërisë “**** ****” sh.p.k.;
3. Mandat arkëtimi nr. ***, datë **.5.2014, i Shoqërisë “**** ****” sh.p.k.;
4. Mandat arkëtimi nr. ***, datë **.9.2014, i Shoqërisë “**** ****” sh.p.k.;

5. Deklaratë për revokim kontrate prenotimi, nr.*** rep., datë **.4.2015, akt i Shoqërisë “*** **” sh.p.k.;

6. Mandat arkëtimi nr.***, datë **.4.2015, i Shoqërisë “*** **” sh.p.k.;

nënshkrimi poshtë rekuizitës së emrit me shkronja të printuara: “Sokol Ngresi”, është ose jo nënshkrimi origjinal i subjektit të rivlerësimit, Sokol Ngresi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA